

**VENDIM**  
**Nr. 453, datë 19.6.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 119, DATË 27.2.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT ‘PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E PRONAVE SHTETËRORE’, ME NËNPROJEKTET SI ‘KORPUSI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA’, ‘QENDRA PËR ZHVILLIMIN MULTIFUNKSIONAL TIRANË’ DHE ‘COPËZAT’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”; të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënie të pronës shtetërore me qira, enfitozoë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 119, datë 27.2.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit ‘Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore’, me nënprojektet si ‘Korpusi i institucioneve të pavarura’, ‘Qendra për zhvillimin multifunksional Tiranë’ dhe ‘Copëzat’”, bëhen ndryshimi dhe shitesa e mëposhtme:

a) Pasuria me nr. 149/31, në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 948.5 m<sup>2</sup>, zëvendësohet me pasurinë me nr. 149/37, në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 765 m<sup>2</sup>, lloji “pemëtore”.

b) Shtojcës nr. 1, bashkëlidhur vendimit, i shtohen pronat sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> )	Nga sip.		Pemëtore	Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m <sup>2</sup> )	Ndërtesë (m <sup>2</sup> )		
8210	2/668	157	157	-		Shtet
8210	2/725	10.82	10.82	-		Shtet
8270	3/608	250	250	-		Shtet
8270	3/609	233.4	233.4	-		Shtet
3140	219/16/4	2910	-	-	2910	Shtet